



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOS QENDRA PER SHËRBIM TË QY CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Nr. i faq. 2	Data: 04/02
Br. str. 02	Datum: 2025
KAMENICËJA	

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.21, datë:04.02.2025

Në mbështetje të nenit 13, 17 shkronja p) dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 50, neni 62 paragrafi 62.2, neni 63, neni 65 dhe neni 66 të Rregullores Sh.01.Nr.6969 të datës 04.03.2015 të Komunës së Kamenicës për Shërbime Publike, si dhe neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për Formimin e Komisionit për Verifikimin e Panove dhe Reklamave në Hapësira Publike

- Formohet Komisioni për verifikimin e panove dhe reklamave në hapësirat publike të Komunës së Kamenicës në këtë përbërje:
 - Ibrahim Kastrati (DSHPAIE), Kryesues;
 - Sami Morina (DSHPAIE), anëtar; dhe
 - Besim Morina (DSHPAIE), anëtar.
- Detyrat e Komisionit sipas pikës (1) të këtij vendimi janë:
 - Identifikimi dhe verifikimi i panove dhe reklamave të vendosura në:
 - Rrugët publike dhe trotuarët.
 - Sheshet dhe parqet publike.
 - Objektet publike.
 - Hapësirat e tjera publike të administruara nga Komuna.
 - Kategorizimi i panove dhe reklamave sipas statusit të tyre:
 - Me leje të rregullt.
 - Pa leje ose në kundërshtim me rregulloren komunale.

2.2.3. Për largimin e panove pa leje, Komisioni do të bashkëpunojë me Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca, si dhe Ndërmarrjen Publike Lokale Dardana Sh.A.

2.2.4. Propozimi i masave për trajtimin e panove të vendosura pa leje.

3. Komisioni si në pikën (1) të këtij vendimi në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca ndërmerr masa në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për shfrytëzuesit e hapësirave publike të cilët nuk kanë dokumentacionin përkatës për shfrytëzim.
4. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën (2) të këtij vendimi, Komisioni i Raporton Kryetarit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca dhe Arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.23, datë: 04.02.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, si dhe neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. CAKTOHET, **znj. Burbuqe Leka**, Zyrtare Autorizues për Projektin: “**Ndërtimi i tezgave për tregje mobile**”.
2. Zyrtarja Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t’i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtarja Autorizuese e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtarja Autorizues **znj.Burbuqe Leka**, Zyrtare Autorizues për Projektin: “**Ndërtimi i tezgave për tregje mobile**”.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t’i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Burbuqe Leka dhe
- Q.SH.Q-arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOS
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 2949
U. Br.

Nr. i faq. 1 Data: 06/02
Br. str. Datum: 2025

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICES
OPSTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.26, datë: 05.02.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Arsyetimi i datës 03.02.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 88.60 €

1. Lejohet pagesa e faturës 0005147 të datës 30.01.2025, në shumën prej 88.60 € për shpenzimet e krijuara në Fast Food "Linda" në Kamenicë, Me rastin e organizimit të Flakës së Janarit, në kuadër të aktiviteteve kulturore, është shfaqur drama "Vajza e mbështjellur me flamur", Në shenjë mirënjohje për aktorët dhe për të mirëpritur mysafirët, është organizuar një darkë me vlerë prej 88.60 €.
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 85029 i DKRS-së, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimit.
3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi për faturën i datës 03.02.2025, Fatura 0005147 të datës 03.02.2025, kuponi fiskal me numër 0027 i datës 30.01.2025 në shumën prej 88,60 €, dhe Fotografi lidhur me aktivitetin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DKRS-së;
- DBF-së; dhe
- Arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj

Sh. 02 Nr. 2960
U. Br.

Nr. i faq. 1 Data: 06/02
Br. str. Datum: 2025

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS

OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.25, datë: 05.02.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Arsyetimi i datës 21.01.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 120.00 €

1. Lejohet pagesa e faturës 0005146 të datës 21.01.2025, në shumën prej 120.00 € për shpenzimet e krijuara në Fast Food Linda në Kamenicë, Me rastin e organizimit të Flakës së Janarit, në kuadër të aktiviteteve kulturore, është mbajtur edhe Ekspozita e artistëve të Komunës së Kamenicës, Në shenjë mirënjohje për kontributin e artistëve dhe për të mirëpritur mysafirët e veçantë, është organizuar një koktej modest me vlerë prej 120.00 €.
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 85029 i DKRS-së, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimit.
3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi për faturën i datës 21.01.2025, Fatura 0005146 të datës 21.01.2025, kuponi fiskal me numër 0021 i datës 21.01.2025 në shumën prej 120,00 €, dhe Fotografi lidhur me aktivitetin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t'i dërgohet:


- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DKRS-së;
- DBF-së; dhe
- Arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOS.	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY. CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Sh. <u>02</u>	Nr. <u>3115</u>
U. _____	Br. _____
Nr. i faq. <u>6</u>	Data: <u>07/05</u>
Br. str. _____	Datum: _____
KAMENICË/A <u>2025</u>	

DRAFT RREGULLORE NR. _____

PËR PLOTËSIM NDRYSHIM TË RREGULLORES SH.01 NR.31251 E DATËS 29.09.2022
PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURËN E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Dhjetor, 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c), nenit 40 paragrafi 40.2, shkronja a) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale i Republikës së Kosovës në harmoni me dispozitat e nenit 70 shkronja h) të Statutit Sh.01 Nr.2023 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës dhe nenit 12 të Rregullorës Nr.01/2013 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve Komunale, Kuvendi I Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më miratoi këtë:

DRAFT-RREGULLORE PËR PLOTËSIM NDRYSHIM TË RREGULLORES SH.01 NR.31251 E DATËS 29.09.2022 PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURËN E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

**Neni 1
Qëllimi**

Me anë të kësaj Rregullore plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja Sh.01 Nr.31251 e datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve

**Neni 2
Përjashtim nga ndarja e subvencioneve**

Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, pas nën nën paragrafit 3.3.1 shtohet nën nën paragrafi 3.3.2 me tekstin si në vijim:

3.3.2 Përjashtim nga nën nën paragrafi 3.3.1 bën subvencionimi i qumështit/litër

Neni 6, paragrafi 3, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3. Përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë subvencionet e ndara për personat fizik në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, subvencionet e ndara nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hvilim Rural si dhe nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Neni 6, paragrafi 3, shtohet nënparagrafi 3.4 me tekstin si në vijim:

3.4. Përfituesi i trajnimit në punë dhe praktikës në punë për të papunësuarit në bazë të kohëzgjatjes të përcaktuar në kontratë mund të jetë përfitues i subvencionit të pagës më shumë se një herë brenda vitit.

Neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1.1 Përjashtim nga paragrafi 1 I këtij neni bëjnë subvencionet e ndara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tek subvencionet për Mirëqenie Sociale specifiku për subvencionet në Nenin 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1.

Neni 3 Vendimmarrja

Neni 11, paragrafi 2, shtohet nënparagrafi 2.1 me tekstin si në vijim:

2.1. Ndaj vendimeve për ndihma momentale në fushën e shëndetësisë nuk lejohet e drejta e ankesës.


Neni 4 Subvencionet në fushën e Arsimit

Neni 5 Subvencionet në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Neni 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3.1. Familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar

Neni 26, paragrafi 3, shtohet nënparagrafi 3.5 me tekstin si në vijim:



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



3.5 Përkrahje financiare për viktimat e dhunës në familje

Neni 26, shtohet paragrafi 13 dhe 14 me tekstin si në vijim:

13. Përkrahje financiare për viktimat e dhunës në familje

13.1 Subvencionimi ndahet në tre (3) komponente:

13.1.1 Subvencionimi i banimit;

13.1.2 Subvencionimi i mjeteve për jetesë (aplikohet kur viktimat nuk është përfituese nga skema e ndihmës sociale);

13.1.3 Në rast se viktimat ka fëmijë në përkujdesje, kjo shumë rritet për secilin fëmijë;

13.2 Përfituesit e subvencioneve nga paragrafi 13 i këtij neni jo domosdoshmërisht mund të jenë përfitues nga tre komponentet.

13.3 Vlera maksimale e përkrahjes financiare, në rast kur aplikohen të tre komponentët të përcaktuar nga paragrafi....., nuk mund të tejkalojë shumën prej.....

13.4 Ky subvencion mund të ofrohet në një afat prej 6 muajve i cili mund të vazhdohet jo më shumë se 2 vite por i njëjti mund të ofrohet edhe në një afat më të shkurtër, por e njëjta mund të ndërpritet edhe më herët se sa është përcaktuar paraprakisht, sipas vlerësimeve të Qendrës për Punë Sociale dhe Komisionit përkatës.

13.5 Qendra për Punë Sociale bën propozimin pranë Komisionit përkatës për ndërprerjen e përkrahjes financiare për shkak të ndryshimit të rrethanave si në vijim:

13.5.1 Punësimi/rikthimi në marrëdhënie pune;

13.5.2 Bashkimi familjar;

13.5.3 Ndryshimi i vendbanimit;

13.5.4 Ndryshimi i statusit martesor;

13.5.5 Të gjitha rrethanat e tjera që e vlerëson QPS-ja.


14. Dokumentet e nevojshme për aplikim për ndarje të subvencioneve e përcaktuara në paragrafin 13 të këtij neni janë:

14.1. Dokumenti i cili dëshmon se rasti është i hapur në Polici;



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



- 14.2.Dokumenti i cili dëshmon se viktima ka paraqitur Kërkesë për urdhër mbrojtje apo procesverbali, vendimi i gjykatës (opsionale);
- 14.3.Dokumenti i identifikimit;
- 14.4.Certifikatat e fëmijëve
- 14.5.Certifikata e bashkësisë familjare
- 14.6.Konfirmimi bankar;
- 14.7.Kontrata e noterizuar e banimit;
- 14.8.Dëshmi apo referim nga Strehimorja (opsionale);
- 14.9.Konstatim Zyrtar nga QPS-ja.

Neni 6

Subvencionet në fushën e Zhvillimit Ekonomik

Neni 17, shtohet paragrafi 4, 5, 6 me tekstin si në vijim:

4. Komuna mund të ofrojë trajnime dhe praktikë në punë për të papunësuarit të regjistruar si punë kërkues, të cilët janë të diplomuar nga institucionet e arsimit të mesëm dhe të lartë, dhe janë të papunë në periudhë afatgjate.
- 5.Punëdhënësit nga sektori privat, sektori publik, ndërmarrjet publike dhe OJQ-të mund të jenë bashkëpjesmarrës në këtë proces, të cilët shprehin interesimin e tyre për të hyrë në partneritet për të angazhuar praktikantë me pagesë.
6. Kohëzgjatja e trajnimit dhe praktikës në punë mund të jetë nga 2(dy) deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj, jo më shumë se 40 (dyzetë) orë në javë dhe inicohet me Thirrje Publike, e cila përpilohet sipas kushteve dhe nevojave të arritjes së objektivave të zhvillimit ekonomik.

Neni 7

Kriteret e përgjithshme


Neni 18, shtohet paragrafi 6 dhe 7 me tekstin si në vijim:

6. Përfituesi i subvencionit si praktikant duhet të jetë i papunësuar dhe të jetë I regjistruar si punëkërkues të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit pas diplomimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



7. I papunësuar i nuk mund të jetë përfitues i subvencionit si praktikant më shumë se 1 (një) herë brenda 3 (tre) viteve.

Neni 8

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik

Neni 21, shtohet paragrafi 2 me tekstin si në vijim:

2. Dokumentet të cilat duhet të dorzohen gjatë aplikimit për trajnim dhe punë prkatike:

2.1. Certifikata e vendbanimit

2.2 Dëshmi mbi përfundimin e shkollimit të mesëm apo të lartë

2.3 Vërtetim që është i regjistruar si punëkërkuar të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit pas diplomimit.

Neni 9

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

Neni 29, paragrafi 4 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

4. Komuna në bazë të komisionit të monitorimit të cilin e formon Kryetari i Komunës harton raporte me listën e zezë për përfituesit të cilët nuk e kanë respektuar marrëveshjen për subvencionim si dhe saksione tjera.

Neni 29, shtohet paragrafi 5 dhe 6 me tekstin si në vijim:

5. Komuna në bazë të raportit të monitorimit ofron afat shtesë prej 30 ditësh për përfituesit të cilët nuk kanë realizuar projektin.

6. Komuna do të marrë masa ndëshkimore të cilat specifikohen në marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët , në rast të mospërputhjes së projektit dhe afatit shtesë sipas paragrafit 5 të këtij neni.




Republika e Kosovës
Republika Kosova Sh.
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Nr. 02 Nr. 3290
Br. Br.

Nr. i faq. 2 Data: 10/02
Br. str. Datum: 2025
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.28, datë:07.02.2025

Kryetari i Komunës së Kamenicës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, nenit 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

- 1. FORMOHET** Komisioni për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunës së Kamenicës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Lidiona Marovca, Zyra e Kryetarit, Koordinatorë;
 - 1.2. Petrit Vokshi, Zyrtar për Zotimin e mjeteve buxhetore, anëtar;
 - 1.3. Valdete Berisha, Zyrtare e Lartë për Informim dhe Raportim, Zyra për Informim, anëtare;
 - 1.4. Sabile Kastrati Arifi, Zyrtare për Kuvend, anëtare;
 - 1.5. Liridona Bajra, Zyrtare e Shërbimeve Sociale, anëtare;
 - 1.6. Venera Dërmaku, Zyrtare për Kulturë, anëtare;
 - 1.7. Florentina Kryeziu, Udhëheqëse e Sektorit për Siguri dhe Emergjencë, anëtare;
 - 1.8. Mehmet Thaçi, Përgjegjës për Planifikim, anëtar;
 - 1.9. Enver Ismajli, Inspektor i tregut, anëtar;
 - 1.10. Burim Krasniqi, Përgjegjës për PTK/KEK, anëtar;
 - 1.11. Sami Morina, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike dhe Ambient, anëtar;
 - 1.12. Ibrahim Kastrati, Përgjegjës për Ambient, anëtar;
 - 1.13. Vesna Aleksic, Zyrtare Administrative, anëtare;
 - 1.14. Hysen Jerliu, Zyrtar i Qark. Rrugor, anëtar;
 - 1.15. Musah Ismajli, Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit, anëtar;
 - 1.16. Kosovare Maroca, Zyrtare për Barazi Gjinore, anëtare;
 - 1.17. Visar Dërmaku, Drejtoria Komunale e Arsimit, anëtar;
 - 1.18. Ahmet Sylaj, Zyrtar Financiar në QKMF, anëtar;
 - 1.19. Qëndresa Kastrati, Zyrtare për zhvillim ekonomik, anëtare; dhe
 - 1.20. Ali Berisha, Inspektor i Ndërtimit, anëtar.
- 2.** Komisioni i përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi ka për detyrë të merret me matjen-grumbullimin, raportimin dhe analizimin e treguesve të shërbimeve për fushat e drejtorisë të cilat i përkasin dhe të njëjtat ia dërgojnë Koordinatorës për Performacë të Komunës.

3. Koordinatorja është përgjegjës për pranimin e raporteve nga çdo sektor dhe të njëjtin raport bashkë me anëtarët ta analizojnë dhe si raport përfundimtar ta përcjellë në Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe pas aprovimit të Raportit nga Kryetari të përcjellët në Ministrinë e Administratës të Pushtetit Lokal (MAPL).
4. Me këtë Vendim Shfuqizohet Vendimi Sh.02.Nr.13101 i datës 12.04.2023 dhe Vendimet për plotësim ndryshim Sh.02.Nr.5816 i datës 20.02.2024, Vendimi Sh.02.Nr.6016 i datës 21.02.2024 dhe Vendimi Sh.02.Nr.6248 i datës 23.02.2024.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorive Komunale, Anëtarëve të Komisionit dhe QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 3416
Br. 1
Data: 12/02 Datum: 2025
KAMENICË/2025

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.29, datë:10.02.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, Memorandumi i Mirëkuptimit Sh.02.Nr.2914 i datës 05.02.2025 për Financimin e Projektit “Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e mbeturinave organike - Kamenicë” e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Uran Berisha, Zyrtar Autorizues, për Financimin e Projektit: “Ndërtimi i impiantit për trajtimin e mbeturinave organike - Kamenicë”.**
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Uran Berisha**, për Projektin: **“Ndërtimi i impiantit për trajtimin e mbeturinave organike – Kamenicë”.**
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Uran Berisha (Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor); dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Sh. 02 Nr. 3422
U. Br.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Nr. i Fakt.
Pr. Str. 2
Data: 12/02
Datum: 2025
KAMENICËJA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.30, datë: 11.02.2025

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neni 44 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e nenit 21 të Rregullores së MF-Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, neni 6 i Rregullorës së Brendëshme Sh.02.Nr.33174 të datës 16.10.2024 për procedurat e menaxhimit të pasurisë jofinanciare në Komunën e Kamenicës, Kërkesa Sh.02.Nr.3225 e datës 10.02.2025 e parashtruar nga znj. Merita Kryeziu (Zyrtare e Pasurisë) për formimin e Komisionit për vlerësimin e pasurisë jofinanciare, neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me qellim të përmbushjes së këtyre obligimeve, Kryetari i Komunës, merr,

VENDIM

Për formimin e komisionit për vlerësimin e pasurisë jofinanciare të komunës së Kamenicës dhe organeve vartëse të saj

1. **FORMOHET**, komisioni komunal për vlerësimin e pasurisë jofinanciare të administratës komunale, institucioneve shëndetësore dhe atyre arsimore, në këtë përbërje:
 - 1.1. Petrit Vokshi (DFB), kryesues;
 - 1.2. Sabile Kastrati Arifi (DAP), anëtare; dhe
 - 1.3. Florentina Kryeziu (DSHPAIE), anëtare.
2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jofinanciare janë:
 - 2.1. Vlerësimi i pasurive të dëmtuara;
 - 2.2. Vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pasurive;
 - 2.3. Prezantimi i dëshmimeve për vlerësimin e pasurisë;
 - 2.4. Përgatitja e raportit për pasurinë jofinanciare që duhet të largohet nga përdorimi;
 - 2.5. Vlerësimi i kërkesave që paraqet Zyrtari i Pasurisë, të cilat rrjedhin nga Raporti i Inventarizimit (për asetet jashtë përdorimit), në formë të përmbledhur. Kërkesën për vlerësim e paraqet Zyrtari i Pasurisë së Komunës;

- 2.6. Vlerësimi i pasurive që kanë mungesë të dokumentacionit burimor lidhur me vlerën financiare të tyre, në rastet e pranimit të donacioneve nga organizatat tjera buxhetore, OJQ, apo institucione të tjera. Vlerësimi duhet të bazohet në çmimin aktual të tregut për pasurinë.
3. Komisioni si nga pika 1 e këtij vendimi është i obliguar që për punën e vet të përgatit raportin për vlerësimin e pasurisë në përputhje me dispozitat e Rregullores MF-Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullorës së Brendëshme Sh.02.Nr.33174 të datës 16.10.2024 për procedurat e menaxhimit të pasurisë jofinanciare në Komunën e Kamenicës, të cilin raport ja paraqet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, si dhe një kopje Kryetarit të Komunës.
 4. Mandati i Komisionit zgjat deri në përfundimin e të gjitha detyrave të ngarkuara, përfshirë vlerësimin e pasurive jofinanciare të Komunës së Kamenicës dhe organeve vartëse të saj, si dhe përgatitjen e raporteve përkatëse.
 5. Vendimit i bashkangjitet Kërkesa Sh.02.Nr.3225 e datës 10.02.2025 e parashtruar nga znj. Merita Kryeziu (Zyrtare e Pasurisë) për formimin e Komisionit për vlerësimin e pasurisë jofinanciare.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorive Komunale; dhe
- QSHQ-arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRABANA

Sh. Nr. 02 Nr. 3504
Br. str. 1 Data: 13/02
Datum: 2025
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.31, datë: 12.02.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neni 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e Rregullores së MAPL Nr.02/2021 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunës, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 70 paragrafi 70.1 dhe neni 82 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, mori këtë:

VENDIM

Për formimin e grupit punues për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.01/2016 për Ngarkesa, Tarifa, Taksa dhe Gjobat Komunale

- FORMOHET**, grupi punues për hartimin e Draft Rregullores për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2016 për Ngarkesa, Tarifa, Taksa dhe Gjobat Komunale, Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
 - 1.1. Hysen Jerliu (DSHPAIE), kryesues;
 - 1.2. Qëndresa Kastrati (DZHED), anëtare;
 - 1.3. Ramadan Guda (DKA), anëtar;
 - 1.4. Ismete Thaqi (DSHMS), anëtare;
 - 1.5. Venera Dërmaku (DKRS), anëtare;
 - 1.6. Arben Hoxha (DBF), anëtar;
 - 1.7. Fisnik Kastrati (DAP), anëtar;
 - 1.8. Besart Fejzullahu (DUPH), anëtar; dhe
 - 1.9. Ilirida Zubaku (DPKGJ), anëtare.
- Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt propozimit si nga pika 1 e këtij vendimi, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga ana e drejtorive përkatëse, diskutimet publike dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera qe dalin nga dispozitat ligjore.
- Më rastin e përfundimit të procedurave të hartimit dhe diskutimit publik drafti final i dërgohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorive Komunale, Anëtarëve të Grupit Punues dhe arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANI

02 Nr. 3509
Br. 1
Data: 13/02
Datum: 2025
KAMENICEJA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.36 datë:12.02.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Behar Hyseni (DKRS), Zyrtar Autorizues për Projektin: “Servisimi sistemit të ngrohjes në Shtëpi të kulturës dhe palestër”.**
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t’i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Behar Hyseni**, për Projektin: **“Servisimi sistemit të ngrohjes në Shtëpi të kulturës dhe palestër”**
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t’i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Behar Hyseni (DKRS); dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICES
OPSTINA KAMENICA
KRYETARI I KOMUNES
PRESIDENIK OPSTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAFANA

Sh. U. 02 Nr. 3515
Br. 1 Data: 13/02
Br. str. Datum: 2025
KAMENICEJA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.37 datë:12.02.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Behar Hyseni (DKRS), Zyrtar Autorizues për Projektin: “Servisimi i projektorit kryesor të kinemasë”.**
2. Zyrtaari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtaarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtaari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t’i ketë dorëzuar Zyrtaarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtaari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtaari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtaari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtaarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtaari Autorizues **z. Behar Hyseni**, për Projektin: **“Servisimi i projektorit kryesor të kinemasë”.**
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t’i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Behar Hyseni (DKRS); dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBSIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

02 Nr. 3518
Er. 3518

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.32, datë:12.02.2025

Nr. i faq. 1
Er. str. KAMENICË/A

Data: 13/02
Datum: 2025

